




Planuar / Doretuar Prilloga/Produkt Received/Delivered	29.03	2022	2	viti god year
Organ /Njësia Organ /Unit	Nr Prot Bil Prot Prot No	Shtojca Prilog Appendix	Sasia Kolicina Quantity	
SKIMSHK	1679/2022		114	



Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosovo

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës
Nezavisni Nadzorni Odbor Civilne Službe Kosova
Independent Oversight Board for the Civil Service of Kosovo

A.nr.129/2022

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës–Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave i përbërë nga: Eshref Shabani-kryetar, Malsore Gashi-Bajraktari dhe Jeton Koca-anëtarë, me Flakron Gashi-Zyrtar i Lartë për Bashkëpunim Profesional në cilësinë e procesmbajtësit, ka shqyrtuar ankesën A.nr.129/2022 të datës 14.02.2022 të parashtruar nga ankuesi [redacted] i përfaqësuar me autorizim nga [redacted]

me adresë: [redacted] Komuna e Vushtrisë, në çështjen juridike “Ndërprerje e marrëdhënies së punës”, duke vepruar në pajtim me nenin 6 paragrafin 1 nën paragrafin 1.1 dhe nenin 18 paragrafin 1 nën paragrafin 1.2 të Ligjit Nr. 06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës dhe Rregulloren Nr. 02/2018 për Rregullat dhe Procedurat e Ankesave në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, në seancën për këshillim dhe votim, të mbajtur me datë 29.03.2022, mori këtë:

V E N D I M

- I. APROVOHET si e bazuar ankesa me numër A.nr.129/2022 e datës 14.02.2022 e parashtruar nga ankuesi [redacted]
- II. SHFUQIZOHET Vendimi me numër:02-116-01-003278/22 i Komisionit Disiplinor i datës 19.01.2022, ndërsa ankuesi *kthehet* në vendin e punës dhe ushtrimin e detyrave të tij të punës sipas Aktit të Emërimit të datës 03.03.2021 me numër:02-112/01-0011368/20.
- III. OBLIGOHET Kryetari i Komunës së Skenderajt të bëjë zbatimin e këtij vendimi në afat prej pesëmbëdhjetë (15) ditësh nga dita e pranimit të tij.
- V. Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, duhet të njoftohet me shkrim pas ndërmarrjes së veprimeve në pajtim me këtë vendim

A r s y e t i m

Ndaj ankuesit [redacted] sipas shkresave të lëndës i punësuar në Komunën e Skenderajt, në pozitën “Zyrtar për procedimin e të dhënave”, udhëheqësi i tij i drejtpërdrejtë i ka iniciuar procedurën disiplinore për shkelje të rënda të detyrave të punës pranë komisionit disiplinor me datë 20.12.2021.

Komisioni Disiplinor i Komunës së Skenderajt me datë 19.01.2022 ka nxjerrë vendimin me numër:02-116-01-003278/22 duke i shqiptuar ankuesit masën disiplinore “Largim nga Shërbimi Civil”.



Ankuesi kundër vendimit të Komisioni Disiplinor i Komunës së Skenderajt të datës 19.01.2022 ka parashtruar ankesë në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës me datë 14.02.2022 përmes përfaqësuesit të autorizuar Avokatit [REDACTED]

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës me datë 21.02.2022, ka proceduar kërkesën për përgjigje në ankesë tek Komuna e Skenderajt, ndërsa me datë 02.03.2022 Këshilli ka pranuar përgjigjen në ankesë se bashku me shkresat e lëndës.

Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave, ka administruar këto prova: Ankesën e ankuesit të parashtruar në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbim Civil të Kosovës të datës 14.02.2022 me numër prot:717/2022; Prokurën e datës 20.01.2022; Listën e pagës së ankuesit për periudhën kohore prej datës 11.10.2019 deri me datë 03.02.2022; Kërkesën për përgjigje në ankesë e datës 21.02.2022 me numër protokolli:900/2022; Përgjigjen në kërkesë të datës 02.03.2022 me numër prot:1129/2022; Akt emërimit e ankuesit të datës 03.03.2022; Përshkrimin e detyrave të punës së ankuesit; Vërejtjen me shkrim të datës 08.02.2021; Vërejtjen me shkrim të datës 15.07.2021; Vendimin për themelimin e Komisionit Disiplinor i datës 12.02.2021; Kërkesën/njoftimi për inicim të procedurës disiplinore për ankuesin i datës 21.12.2021; Kërkesën për inicimin e procedurës disiplinore e datës 20.12.2021; Njoftimin e datës 01.11.2022 dërguar përmes e-maili; Vendimi i Komisionit Disiplinore të Komunës së Skenderajt i datës 02-116-01-0003278/22; Fletë kthesën e datës 20.01.2022; Formulari për vlerësimin e rezultateve në punë për vitin 2020 i datës 30.12.2020; Formulari për vlerësimin e rezultateve në punë për vitin 2021 i datës 30.12.2021; Procesverbali e seancës së mbajtur me datë 30.12.2021; Procesverbali e seancës së mbajtur me datë 14.01.2022; Procesverbali e seancës së mbajtur me datë 17.01.2022; Procesverbali e seancës së mbajtur me datë 19.01.2022; Listën e pagës së ankuesit për periudhën kohore prej datës 01.01.2021 deri me datë 31.12.2021; Raportin e datës 25.02.2022 për prezencën në punë për periudhën prej datës 01.11.2021 deri me datë 31.01.2022; Kërkesën për qasje në program e datës 29.03.2019; Bisedën e shkëmbyer përmes sms në rrjete sociale ndërmjet ankuesit dhe udhëheqësit të tij; Raportin javor të punës për periudhën kohore prej datës 09.07.2021 deri me datë 16.07.2021; Raportin javor të punës për periudhën kohore prej datës 01.04.2021 deri me datë 30.04.2021; E-mailin 30.09.2019 dërguar nga [REDACTED] për Raportin javor të punës për periudhën kohore prej datës 01.05.2021 deri me datë 31.05.2021; E-mailin 30.08.2021 dërguar nga [REDACTED] për Raportin javor të punës për periudhën kohore prej datës 13.08.2021 deri me datë 28.08.2021; Raportin javor të punës për periudhën kohore prej datës 08.04.2021 deri me datë 23.04.2021; E-mailin 26.04.2021 dërguar nga [REDACTED] për E-mailin 07.06.2021 dërguar nga [REDACTED] për E-mailin 16.08.2021 dërguar nga [REDACTED] për Raportin javor të punës për periudhën kohore prej datës 02.08.2021 deri me datë 13.08.2021; E-mailin 10.12.2021 dërguar nga [REDACTED] për Raportin javor të punës për periudhën kohore prej datës 01.12.2021 deri me datë 10.12.2021; E-mailin 17.12.2021 dërguar nga [REDACTED] për Raportin javor të punës për periudhën kohore prej datës 10.12.2021 deri me datë 17.12.2021; E-mailin 24.12.2021 dërguar nga [REDACTED] për Raportin javor të punës për periudhën kohore prej datës 17.12.2021 deri me datë 24.12.2021; Zarfë e datës 28.02.2022.

Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave pasi ka shqyrtuar të gjitha shkresat e bashkangjitura të lëndës të dërguara nga palët, ka konstatuar se ankesa e ankuesit **është e bazuar**, sepse:

Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave ka shqyrtuar pretendimet ankimore të ankuesit se Komisioni Disiplinor me rastin shqiptimit të masës disiplinore "*Largim nga Shërbimi Civil*" ka zbatuar gabimisht dispozitat ligjore të Ligjit Nr.06/L-114 për Zyrtarët Publik dhe Rregullores Nr.11/2020 për Disiplinën dhe Ankesat e Zyrtarëve Publikë dhe pas administrimit të shkresave të lëndës ka ardhur në përfundim se masa disiplinore e shqiptuar ndaj ankuesit, është masa më e rëndë që mundë t'i shqiptohet nëpunësit civil siç përcaktohet edhe me nenin 7 paragrafi 1 Ligjit Nr.06/L-114 për Zyrtarët Publik ku përcaktohet se: "*Masat disiplinore, të cilat mund të zbatohen ndaj nëpunësit civil, janë: 1.1. vërejtje; 1.2. ndalimi nga 20% deri në 40% e pagës për një periudhë deri në gjashtë muaj; 1.3. ndalimi i ngritjes në detyrë, duke përfshirë këtu rritjen në*



shkallën e pagës për një periudhë nga dy deri 5 vjet; 1.4. largimi nga Shërbimi Civil”, ndërsa në bazë të nenit 10 paragrafi 6 të Rregullores Nr.11/2020 për Disiplinën dhe Ankesat e Zyrtarëve Publikë përcaktohet se: “Për procedurën dhe vendimmarrjen e komisionit disiplinor, zbatohen dispozitat e Ligjit për Procedurën e Përgjithshme Administrative” ka konstatuar se komisioni disiplinor me rastin e nxjerrjes së akteve, respektivisht zhvillimit të procedurës disiplinore duhet të kujdeset që të zbatohen në plotni dispozitat ligjore të Ligjit Nr.05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative

Po ashtu, Kolegji ka gjetur se Komisioni Disiplinor i themeluar nga Kryetari i Komunës së Skenderajt me datë 12.02.2021 përmes vendimit më numër: 02-020/01-0008116/21 nuk i përmbush kriteret e përcaktuar sipas nenit 49 paragrafi 5 të Ligjit Nr. 06/L-114 për Zyrtarët Publikë ku përcaktohet: “1. Në çdo institucion, në fushën e veprimit të këtij ligji, themelohet një komision disiplinor me mandat 3 vjeçar, që përfshin së paku një përfaqësues të njësisë përgjegjëse” si dhe nenit 10 paragrafi 2 të Rregullores (QRK) Nr. 11/2020 për Disiplinën dhe Ankesat e Zyrtarëve Publikë ku përcaktohet se: “Komisioni disiplinor përbëhet nga tre (3) anëtarë të cilët duhet të jenë nëpunës civilë, nga të cilët njëri duhet të jetë jurist dhe ka këtë përbërje: 2.1. Nëpunës civil i nivelit drejtues – Kryesues i Komisionit; 2.2. Nëpunës civil i nivelit profesional – anëtar dhe 2.3. Nëpunës civil i njësisë së burimeve njerëzore – anëtar.”, ndërsa në vendimin për themelimin e Komisionit Disiplinor kriteret e përcaktuara si më lart mungojnë, andaj për anëtarët e Komisionit Disiplinor si:

dhe nuk dihet se çfarë pozitash mbajnë në kuadër të detyrave dhe përgjegjësi të punës në shërbimin civil dhe po ashtu nuk është i njohur fakti nëse ndonjëri prej tyre është jurist apo është i njësisë së burimeve njerëzore, andaj në kuptim të nenit 52 paragrafi 1 nën paragrafi 1.5 të Ligjit Nr.05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative ku përcaktohet se: “Një akt administrativ është i paligjshëm nëse: është në kundërshtim me ligjin material”, dhe mbi këtë bazë Kolegji konstaton se ky vendim nuk është nxjerrë në pajtueshmëri të plotë me ligjin material, ndërsa Kryetari i Komunës së Skenderajt obligohet që ta bëjë plotësimin apo ndryshimin e vendimit të datës 12.02.2021 për themelimin e Komisionit Disiplinor sipas specifikimeve të dhëna në arsyetim të këtij vendimi.

Në bazë të shkresave të lëndës, Kolegji ka gjetur se Komisioni Disiplinor sipas pikës një (1) të dispozitivit të vendimit me numër:02-116-01-003278/22 ka shqyrtuar kërkesën për iniciimin e procedurës disiplinore ndaj ankuesit të datës 20.12.2022, ndërsa vendimin e kanë nxjerrë me datë 19.01.2022, andaj mbi këtë bazë Kolegji konstaton se vendimi i Komisionit Disiplinor i datës 19.01.2022 me numër:02-116-01-003278/22 është nxjerrë në ditën e tridhjetenjë (31), veprim ky në kundërshtim me nenin 12 paragrafi 6 të Rregullores Nr.11/2020 për Disiplinën dhe Ankesat e Zyrtarëve Publikë ku përcaktohet se: “Komisioni disiplinor duhet të marrë vendim brenda 30 ditëve pas pranimit të kërkesës për iniciim të procedurës nga njësia për burime njerëzore” pasi që Komisioni Disiplinor nuk ka arritur të argumentoj datën se kur i njëjti e ka pranuar kërkesën për iniciimin të procedurës disiplinore, sikurse në vendimin në fjalë dhe as në procesverbalet e seancave të mbajtura nga Komisioni Disiplinor sipas datave 30.12.2021; 14.01.2022; 17.01.2022 dhe 19.01.2022 nuk kanë arritur të argumentojnë se cilat prova janë administruar më rastin e nxjerrjes së vendimit përveç deklarimeve seancë të ankuesit dhe iniciuesit të procedurës disiplinore, veprime këto në kundërshtim me nenin 47 paragrafi 1 në paragrafi 1.3 dhe 1.5 të Ligjit Nr.05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative ku përcaktohet se: “Arsyetimi i siguron palës mundësinë që ta kuptojë aktin administrativ. Arsyetimi përmban: 1.3. shkaqet të cilat kanë qenë vendimtare gjatë vlerësimit të provave; 1.5. shkaqet për të cilat nuk është pranuar ndonjëri nga pretendimet e palëve;”, andaj Komisioni Disiplinor me rastin e nxjerrjes së vendimit të ankimuar nuk ka arritur ta sqarojë mjaftueshëm situatën faktike mbi bazën e së cilës është marrë vendimi, respektivisht nuk ka arritur të precizojë ditët apo datën e saktë të periudhës kohore të mungesës në punës, po ashtu në ka arritur të konstatoj nëse ankuesi i ka pranuar për mungesë në punë dy vërejtjet me shkrim të datave respektive 08.02.2021 dhe 15.07.2021 të shqiptuara nga udhëheqësi i drejtpërdrejtë, andaj mbi këtë bazë Kolegji konstaton se mungesa e arsyetimit të mjaftueshëm i vendimit të datës 19.01.2022 me numër:02-116-01-003278/22 të Komisionit Disiplinor të Komunës së Skenderajt është i barabartë me mungesën e tij siç përcaktohet me Ligjin Nr.05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative neni 48 paragrafi 2 i cili përcakton se: “Një arsyetim që është dukshëm i pamjaftueshëm, i paqartë, kundërthënës apo i pakuptueshëm, është i barabartë me mungesën e tij” ndërsa në mbështetje të nenit 52 paragrafi nën paragrafi 1.3 të Ligjit Nr.05/L-031 për Procedurën e

Përgjithshme Administrative ku përcaktohet se: "Një akt administrativ është i paligjshëm nëse: 1.3. është rezultat i shkeljes të dispozitave lidhur me procedurën administrative", Kolegji konstatoi se vendimi i Komisionit Disiplinor i datës 19.01.2021 është i paligjshëm në aspektin e shkeljeve procedurale administrative dhe kritereve të përcaktuara të ligjit material, andaj si i tillë ky vendim shfuqizohet, ndërsa ankesa e ankuesit aprovohet si e bazuar për shkak të metave ligjore të aktit të ankimuar.

Kolegji për shqyrtimin dhe vendosjen e ankesave, vlerëson njëzëri se për shkak të metave ligjore të vendimit të ankimuar në këtë procedurë, të përcaktuara me legjislacionin e aplikueshëm të specifikuar si më lartë në arsyetimin e këtij vendimi, e ka të pamundur të vërtetoj saktë nëse Komisioni Disiplinor i Komunës së Skenderajt ka arritur të konstatoj drejt gjendjen faktike.

Kolegji thekson faktin se, Kryetari i Komunës së Skenderajt në cilësinë e Zyrtarit Kryesor Administrativ, sikurse edhe Komisioni Disiplinor, në rastet kur në të ardhmen përsëriten kërkesat për inicim të procedurës disiplinore apo ka raste të reja të inicimit të procedurave disiplinore ndaj nëpunësve civil, duhet të merren parasysh të gjeturat e theksuara sikurse në arsyetimin e këtij vendimi me qëllim të eliminimit të metave ligjore e procedurale administrative me rastin e nxjerrjes së akteve dhe procedurave të zhvilluara, me qëllim që të mundësohet konstatimi i saktë i gjendjes faktike në rastet e shqiptimit të masave disiplinore e veçanërisht masës Largim nga Shërbimi Civil.

Andaj, pas analizimit dhe vlerësimit të gjitha shkresave të lëndës si dhe duke u bazuar në nenin 6 paragrafi 1 nën paragrafi 1.1 dhe nenit 18 paragrafi 1 nën paragrafit 1.2 të Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, Kolegji vendosi si në dispozitiv të këtij Vendimi.

Vendimi hyn në fuqi në ditën e nënshkrimit nga Kryetari i Kolegjit.

Këshillë juridike: Kundër vendimit të Këshillit, pala e pakënaqur e cila pretendon se vendimi i Këshillit nuk është i ligjshëm mund të iniciojë konflikt administrativ në Gjykatën Themelore në Prishtinë-Departamenti për Çështje Administrative, brenda afatit prej tridhjetë (30) ditësh, nga dita në të cilën i është dorëzuar vendimi. Inicimi i konfliktit administrativ nuk e ndalon ekzekutimin e këtij vendimi.

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS
Lënda me numër A. Nr. 129/2022

Flakron GASHI

Zyrtar për Bashkëpunim Profesional



Vendimi i dërgohet:

- Përfaqësuesit të palës, Avokatit
- Kryetarit të Komunës së Skenderajt,
- Udhëheqësit të Personelit në Komunës së Skenderajt,
- Arkivit të KPMSHCK-së